

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARSIMIT - SEKTOR ARRIWE ARCHIVE SECTOR	
Nr. Org. Org. Unit:	013
Nr. Prot. Prot. No.:	1452
Nr. Faneve Distrance No. pages:	2
Datum: Date:	
27, 04, 15	
Prishtinë / 3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 175/018
Datë: 27 prill 2015

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010*), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe Ligjin nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (*Gazeta zyrtare nr. 8, 1 janar 2007*), nenin 92, paragrafi (d), nxjerr:

VENDIM


1. Shfuqizohet vendimi nr. 2/1023, dt. 19.03.2015 për licencimin e Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL), "Kolegji Evropian i Kosovës" në Prishtinë, për nivelin Bachelor në kohëzgjatje për një vit akademik 2014/2015.
2. Pavlefshmëria absolute e vendimit 2/1023, të dt. 19.03.2015, e shpallur përmes këtij vendimi, ka efekt juridik në kuptim të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.
3. Udhëzohet BPrAL, "Kolegji Evropian i Kosovës" në Prishtinë, në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fuqi, që lindin si pasojë e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 2/1023, të dt. 19.03.2015, objekt procedural i të cilit ishte kërkesa e tij për licencim, nr. 3919, dt. 16 korrik 2014.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT që të njoftoj BPrAL "Kolegji Evropian i Kosovës" për vendimin për shfuqizimin e vendimit nr. 2/1023, dt. 19.03.2015.

5. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit, MASHT që në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë dhe Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, të inspektoj zbatimin e këtij vendimi dhe kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

Arsyetim

Vendimi nr. 2/1023, dt. 19.03.2015, përbën shkelje thelbësore të ligjit, me pasojë pavlefshmërinë absolute të tij, meqenëse është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me ligj, respektivisht, në kundërshtim me kushtet dhe kriteret ligjore për licencim të përcaktuara në Ligjin nr. 04/L-037, për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenin 14 (*Licencimi i bartësve të arsimit të lartë*) dhe Udhëzimin Administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, nenit 7 (*Kushtet dhe kriteret*). Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. dr. Arsim Bajrami, ministër



Vendimi ju dërgohet:

1. BPrAL, "Kolegji Evropian i Kosovës";
2. Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
3. Kabinetit të Ministrit, MASHT;
4. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
5. Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, MASHT;
3. Departamentit të Arsimit të Lartë, MASHT;
6. Departamentit Ligjor, MASHT;
7. Arkivit, MASHT.